



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. destin. Org. i ait	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	768
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	01	Data Datum Date	31.07.2026
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Këshilli Drejtues / Upravni Odbor/ Steering Committee

Nr. 01/768/2026

Datë: 30/07/2026

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe nenin 6, paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/L0197 për Zyrat e Publik me datë 30 Korrik 2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja Nr.06/2026 për Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Akademinë e Drejtësisë.
- II. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit Ekzekutiv të AD-së;
- Drejtoreshës së DSHLP-së;
- Burimeve Njerëzore të AD-së;
- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë.

Fejzullah Rexhepi

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, si dhe nenit 6, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në mbledhjen e mbajtur më datë 30 korrik 2026, miraton:

RREGULLORE NR.06/2026

**PËR PEZULLIMIN DHE PËRFUNDIMIN NGA MARRËDHËNIA E PUNËS NË
AKADEMINË E DREJTËSISË**

KAPITULLI I

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave për pezullimin dhe përfundimin nga marrëdhënia e punës të nëpunësve në Akademinë e Drejtësisë.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha kategoritë e nëpunësve të Akademisë së Drejtësisë, përfshirë Udhëheqësit e Departamenteve, Divizioneve dhe stafin tjetër mbështetës.

Neni 3

Përkufizimet

1.Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

1.1 **Nëpunës** – nënkupton çdo person të punësuar në Akademinë e Drejtësisë me marrëdhënie të rregullt pune sipas legjislacionit në fuqi.

1.2 **LZP** – nënkupton Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik;

1.3 **LAD** – nënkupton Ligjin Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë;

1.4 **Zyrtari Përgjegjës** – Zyrtari i Lartë për Burime Njerëzore;

1.5 **Pezullimi** – ndërprerjen e përkohshme të marrëdhënies së punës pa ndërprerjen e statusit të nëpunësit.

2. Termat e tjerë të përdorur në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 4 **Llojet e pezullimit**

1. Pezullimi nga marrëdhënia e punës mund të bëhet:

1.1. sipas detyrës zyrtare; ose

1.2. me kërkesë të nëpunësit (pezullim vullnetar).

Neni 5 **Pezullimi sipas detyrës zyrtare**

1. Nëpunësit të Akademisë së Drejtësisë i pezullohet marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare në këto raste:

1.1. kur ndaj tij/saj është iniciuar procedurë disiplinore dhe vazhdimi i punës pengon hetimin apo ushtrimin e detyrës;

1.2. kur ndaj nëpunësit civil është ngritur aktakuzë për procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;

1.3. kur nëpunësi mbahet në arrest apo paraburgim;

1.4. kur nëpunësi është i emëruar në ndonjë funksion publik sipas ligjit;

1.5. kur me vendim, gjykata ia pezullon ushtrimin e detyrës;

1.6. në rastet e tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 6
Kohëzgjatja e pezullimit

1. Kohëzgjatja e pezullimit varet nga shkaku përkatës dhe zgjat deri në përfundimin e procedurës përkatëse apo të mandatit.
2. Në rastet e arrestimit ose paraburgimit, pezullimi zgjat deri në lirimin e nëpunësit.
3. Në rastet kur gjykata ka vendosur pezullimin, ai zgjat deri në vendimin tjetër.

Neni 7
Procedura për pezullim

1. Pezullimi sipas detyrës zyrtare bëhet me vendim të Drejtorit Ekzekutiv në koordinim me zyrtarin përgjegjës të Akademisë së Drejtësisë, pas verifikimit të shkakut për pezullim.
2. Vendimi për pezullim duhet të jetë me shkrim dhe t'i komunikohet nëpunësit brenda (3) ditëve të punës.
3. Nëpunësi ka të drejtë të ankohet kundër vendimit për pezullim në afat prej 30 ditësh kalendarike në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës.

Neni 8
Pezullimi vullnetar

1. Nëpunësi mund të kërkojë pezullimin e marrëdhënies së punës për:
 - 1.1. kujdes ndaj anëtarit të ngushtë të familjes që është i sëmurë ose i moshuar (deri në një vit);
 - 1.2. ndjekje të studimeve ose trajnimeve profesionale (deri në dy vite).
2. Kërkesa paraqitet me shkrim dhe duhet të përmbajë arsyetimin dhe dokumentet përkatëse.

Neni 9
Efektet e pezullimit

1. Pas përfundimit të pezullimit, përveç kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në Akademinë e Drejtësisë, sipas LZP-së, nëpunësi kthehet në pozitën e mëparshme të punës.
2. Në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, nëpunësi civil transferohet në një pozitë tjetër ekuivalente.

3. Nëpunësi i nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues në rastet sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, kthehet/transferohet në pozitë për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar.

4. Në rastin e pezullimit për një afat deri në tre (3) muaj, pozita e punës nuk plotësohet deri në përfundimin e pezullimit.

5. Ndërsa në rastin e pezullimit vullnetar për kujdesin ndaj anëtarit të ngushtë të familjes që është i moshuar ose i sëmurë, pozita nuk plotësohet deri në një (1) vit.

6. Për rastet e pezullimit si më poshtë, periudha e pezullimit llogaritet si përvojë pune në shërbimin civil:

6.1. kur ndaj nëpunësit është iniciuar procedurë disiplinore dhe komisioni disiplinor vendos se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenoj ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij;

6.2. kur nëpunësi transferohet për nevoja të institucionit në një organizatë ndërkombëtare apo në një institucion ndërkombëtar;

6.3. kur nëpunësi ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi sipas ligjit të veçantë, deri në transferimin e tij në një pozitë tjetër;

6.4. gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimi më të gjatë se tridhjetë (30) ditë, për nevojat e institucionit;

6.5. në rastin e pezullimit vullnetar për kujdesin ndaj anëtarit të ngushtë të familjes që është i moshuar ose i sëmurë;

6.6. në raste të tjera, të parashikuara shprehimisht me ligj.

7. Për rastet e pezullimit si më poshtë, periudha e pezullimit llogaritet si përvojë pune në Akademinë e Drejtësisë, nëse procedura penale përfundon dhe nëpunësi nuk shpallet fajtor:

7.1. kur gjykata pezullon nëpunësin civil që është person zyrtar nga ushtrimi i detyrës, për kushtet dhe shkaqet e parapara në legjislacionin përkatës në fuqi;

7.2. ndaj nëpunësit civil është ngritur aktakuzë për procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;

7.3. nëpunësi mbahet në arrest apo paraburgim;

7.4. deklarohet i zhdukur deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim gjykatës.

8. Nëpunësi gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, përjashtimisht të rasteve të parashikuara shprehimisht në paragrafin 9 të këtij neni:

9. Përjashtimisht paragrafit 8 të këtij neni, nëpunësi përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës bazë si në vijim:

9.1. deri në gjashtë (6) muaj në këto raste:

9.1.1 kur ndaj nëpunësit është iniciuar procedurë disiplinore dhe komisioni disiplinor vendos se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi, pengon hetimin disiplinor apo mund të çënojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij;

9.1.2 gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimi më të gjatë se tridhjetë (30) ditë për nevojat e institucionit;

9.2. deri në përfundim të pezullimit në këto raste:

9.2.1. kur gjykata pezullon nëpunësen që është person zyrtar nga ushtrimi i detyrës, për kushtet dhe shkaqet e parapara në legjislacionin përkatës në fuqi;

9.2.2. ndaj nëpunësit është ngritur aktakuzë për procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;

9.2.3. nëpunësi mbahet në arrest apo paraburgim;

9.2.4. deklarohet i zhdukur me vendim të formës së prerë të gjykatës, deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim të gjykatës.

10. Në rast se procedura disiplinore apo procedura penale përfundon pa një masë disiplinore, gjegjësisht dënim penal, nëpunësit civil që ka qenë i pezulluar me pesëdhjetë për qind (50%) të pagës së tij, i kompensohet pjesa e ndaluar e pagës bazë.

KAPITULLI II

PËRFUNDIMI I MARRDHËNIES SË PUNËS

Neni 10

Përfundimi i marrëdhënies së punës

1. Marrëdhënia e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve në Akademinë e Drejtësisë përfundon në rastet si në vijim:

- 1.1.për shkaqet e përcaktuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje;
- 1.2.me lirim nga detyra si nëpunës në Akademinë e Drejtësisë sipas nenit 12 dhe 13 të kësaj rregulloreje;
- 1.3.largimi nga detyra si nëpunës në Akademinë e Drejtësisë, si masë disiplinore në përputhje me rregulloren për procedurën disiplinore.

Neni 11

Përfundimi i marrëdhënies së punës rastet e përcaktuara me ligj

1. Marrëdhënia e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve në Akademinë e Drejtësisë, përfundon në rastet, kur:
 - 1.1.nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij;
 - 1.2.nëpunësi humb shtetësinë, kur ajo kërkohet;
 - 1.3.kur merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
 - 1.4.mbushet mosha për pensionim sipas Ligjit të Punës;
 - 1.5.konstatohet paligjshmëria e aktit të emërimit; dhe
 - 1.6.dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.
2. Nëpunësi informohet për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të plotësimit të moshës së pensionimit, gjashtë (6) muaj para datës së pensionimit nga Zyrtari Përgjegjës.
3. Përfundimi i marrëdhënies së punës konform kësaj rregullore, nënparagrafit 1.1, 1.2, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të paragrafit 1 të këtij neni konstatohet brenda shtatë (7) ditëve nga ndodhja apo njohja e shkakut të përfundimit.
4. Vendimet përfundimtare përgatiten nga Zyrtari Përgjegjës dhe nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutiv i AD-së.

Neni 12

Lirimi nga marrëdhënia e punës

1. Marrëdhënia e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve në Akademinë e Drejtësisë përfundon në këto raste:

- 1.1.për shkak të refuzimit të paarsyetuar të nëpunësit për të pranuar transferimin;
- 1.2.kur nëpunësi deklarohej i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.3.pas dy (2) vlerësimeve “e papranueshme” të rezultateve në punë, dy (2) herë radhazi. Si herë e dytë radhazi konsiderohet edhe vlerësimi i veçantë;
- 1.4.kur nëpunësi ushtron të drejtën për pensionim të parakohshëm, sipas kësaj rregullore;
- 1.5.kur nëpunësi i kategorisë së ulët, mesme apo të lartë drejtuese anëtarësohet në një parti politike ose kur nëpunësit e niveleve të tjera bëhen anëtar të organeve drejtuese të një partie politike;
- 1.6.kur nëpunësi që ka pezulluar vendin e punës sipas paragrafit 1, nënparagrafit 1.2 të nenit 4 të kësaj rregullore, themelon marrëdhënie tjetër pune;
- 1.7.me dorëheqje, sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje; dhe
- 1.8.në çdo rast tjetër, të parashikuar me këtë rregullore.

2. Lirimi nga marrëdhënia e punës sipas paragrafit 1 nënparagrafit 1.3 të këtij neni konstatohet brenda dhjetë (10) ditëve nga dhënia e vlerësimit të dytë “e papranueshme”, ndërsa në rastet e tjera brenda dhjetë (10) ditëve nga njohja e shkakut.

3. Vendimet për lirim përgatiten nga Zyrtari Përgjegjës dhe nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë.

Neni 13

Dorëheqja

1. Nëpunësi mund të ofrojë dorëheqje nga pozita. Dorëheqja përbën shkas ligjor për lirim të nëpunësit nga marrëdhënia e punës.

2. Përveç dorëheqjes sipas paragrafit 1 të këtij neni, nëpunësi i emëruar në kategorinë e ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, mund të ofrojë edhe dorëheqje vetëm nga pozita drejtuese që mban.

3. Nëpunësi sipas paragrafit 2 të këtij neni, sistemohet në një pozitë të lirë të kategorisë profesionale me kusht që plotëson kriteret për emërim në pozitën në fjalë.

4. I emëruari në kategorinë e ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese që nuk ka qenë në shërbimin civil para se të emërohet në pozitën për të cilën ofron dorëheqjen, lirohet nga shërbimi civil.

5. Deri në emërimin në një pozitë të kategorisë profesionale, nëpunësi vendoset në listën e pritjes dhe gëzon të drejtat, ashtu siç përcaktohet me dispozitat përkatëse të rregullores për procedurën e pranimit në AD.

6. Nëpunësi në Akademinë e Drejtësisë ofron dorëheqjen me shkrim tek Zyrtari Përgjegjës, ku ushtron detyrën, ose te njësia përgjegjëse në rastin e nëpunësve të kategorisë së lartë drejtuese dhe mban të njoftuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë.

7. Dorëheqja krijon pasoja juridike tridhjetë (30) ditë nga data e paraqitjes.

8. Përgjashtimisht nga paragrafi 7 i këtij neni, në raste të arsyetuara, me kërkesë të nëpunësit dhe me miratimin e njësisë përgjegjëse, dorëheqja krijon pasoja juridike përpara afatit tridhjetë (30) ditor nga dita e njoftimit për dorëheqje.

9. Vendimet për përfundimin e marrëdhënies së punës me dorëheqje përgatiten nga Zyrtari Përgjegjës dhe nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutiv i AD-së.

Neni 14

Pensionimi i parakohshëm

1. Nëpunësi në Akademinë e Drejtësisë mund të kërkojë pensionim të parakohshëm, jo më shumë se dy (2) vite para afatit të përcaktuar për pensionimin e tij.

2. Kërkesa për pensionim të parakohshëm, miratohet nga Drejtori Ekzekutiv i AD-së.

3. Akademia mund të përshpejtojë pensionimin në rast të reduktimit të personelit, pas një riorganizimi, bashkimi me një institucion tjetër, mbylljes së institucionit ose shuarjes së pozitave, për ata nëpunës civil që janë dy (2) vite para datës së pensionimit.

4. Pagesa për pensionim të parakohshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni është shtatëdhjetë për qind (70%) e pagës bazë të fundit të pranuar deri në arritjen e moshës së pensionimit.

Neni 15

Dorëzimi i detyrës

1. Nëpunësi në Akademi i cili përfundon marrëdhënien e punës, lirohet nga detyra apo fiton pensionim të parakohshëm, kur kjo është e mundur, bën dorëzimin e detyrës dhe dokumenteve që lidhen me detyrën të mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, ndërsa mjetet e punës dhe inventarin të njësia përgjegjëse për mbajtjen e mjeteve të punës dhe inventarit fizik.
2. Dorëzimi i detyrës, dokumentacionit, mjeteve të punës dhe inventarit bëhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga data e marrjes së vendimit të lirimit i cili afat mund të zgjatet nga mbikëqyrësi varësisht nga rasti.
3. Në rastet e parapara me ligj dhe këtë rregullore, kur nëpunësi nuk mund të bëjë këtë, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë kryen obligimin e tij sipas paragrafit 1 të këtij neni.
4. Zyrtari Përgjegjës, pas dorëzimit të detyrës sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, është i obliguar të ndërmarrë veprimet e nevojshme për mbylljen e e-mailit dhe ndërprerjen e çfarëdo forme të pagesës së nëpunësit.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.


Fejzullah Rexhepi
Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë